



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 388/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Prishtinë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1550 (njëmijë e pesëqind e pesëdhjet) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 30.10.2013, LVV-ja ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 29.10.2013, në ora 19:00, në sheshin Nënë Tereza, në mbulesën e kanalizimit LVV-ja ka vërejtur të ngjitur ftesën për tubim publik nga AAK-ja . Më tutje ka shtuar se, duke qenë se vendi ku është ngjitur posteri është pronësi publike, ngjitja e materialit zgjedhor është në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 pika b e LZP-së, si dhe me dispozitat e nenit 3.4 të Rregullorës 11/2013 të KQZ-së. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar dy fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, lidhur me ankesën Anr.388/2013, ku ka theksuar se, vendosja e posterëve nuk është bërë nga strukturat, simpatizantët dhe mbështetësit e AAK-së, por nga individ që nuk ia dojnë të mirën AAK-së . Për më tepër ka shtuar se, me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës, më konkretisht Shtabin Zgjedhor për Komunën e Prishtinës, për ta bërë heqjen e këtyre ftesave.

Në përgjigje në ankesë i ka bashkangjitur provat si në vijim :

Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së

Fotografinë në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të ftesave,

Formulari i njoftimit për mbajtjen e tubimit politik

Kërkesën drejtuar shefave të Shtabeve Zgjedhore, për respektimin e Kodit Zgjedhor

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se, si ftesa e subjektit politik AAK është vendosur në mbulesën e kanalizimit, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik AAK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika b) të LZP-së, të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve në rrugë publike nga një subjekt tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik AAK, përveq thënieve se veprimet e tilla nuk janë kryer nga strukturat, simpatizantët dhe mbështetësit e AAK-së, me pretendimin se vendosja ftesave është bërë nga individ që nuk ia dojnë të mirën AAK-së. Për më tepër, në në mes tjerash theksohet se, si dëshmi është bashkangjitur fotografia në të cilën dëshmohet largimi i ftesave, mirëpo për rastin në fjalë nuk është ofruar asnjë dëshmi që kanë ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar, siç kërkohet nga dispozitat e nenit 32.6 të LZP-së.

PZAP-i, konstatoi se subjekti politik AAK ka rënë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase e ka vendosur njoftimin e tyre në mbulesën e rrjetit të kanalizimit mbi rrugët publike, shkelje për të cilën është i paraparë dënimi me gjobë, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 388/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*